



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 498/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Vushtrri, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e parregullt ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Vushtrri.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV-ja me datë 04.11.2013, në të cilën ka pretenduar se, me datë 03.11.2013 rreth orës 12:00 në Vushtrri, në fshatin Prelluzhë personat të nacionalitetit serb kanë tentuar që të votojnë me dokumente të Republikës së Serbisë. Më tutje ka shtuar se në vend të ngjarjes pak para mbylljes së vendvotimit (VV) kanë arritur Përfaqësuesi Special i KE-së dhe Ambasadori i Britanisë së Madhe, ku kanë insistuar që komisionari i LVV-së ta nënshkruaj procesverbalin, pra të njëjtin ka refuzuar ta nënshkruaj. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se të gjitha këto veprime e cenojnë rregullimin e paraparë me LZP si dhe me Rregullat Zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi rregullsinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e parregullt

Me ankesën e parashtruar nga LVV-ja pretendohet se, me datë 03.11.2013 rreth orës 12:00 në fshatin Preluzhë, komunë e Vushtrrisë, personat të nacionalitetit serb kanë tentuar që të votojnë me dokumente të Republikës së Serbisë, duke e penguar mbarëvajtjen e rregullt të procesit të votimit.

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e parregullt pasi që ajo nuk është e nënshkruar nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës, andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 3.6 pika d të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 498/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*